



## Rreth botuesit:

Qendra për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve (ADRC) është organizatë me qendër në rajonin e Mitrovicës, puna e së cilës është e përqendruar në inkurajimin e komunikimit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë ndërmjet komuniteteve dhe ndërmjetësimin e qasjes në drejtësi.

ADRC kontribuon në iniciativat dhe angazhimet më të gjera të pajtimit në rajonin e Mitrovicës duke ndërtuar potenciale njerëzore për dialog dhe negociata dhe duke siguruar një kornizë për angazhimin ndëretnik.

Qendra për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve - Qendra për Ndërmjetësim Mitrovicë

Adresa: "Oliver Ivanović/Sami Frashëri", Nr.52 Mitrovicë, Kosovë

Kontakti: [info@mediation-mitrovica.org](mailto:info@mediation-mitrovica.org)

Website: [www.mediation-mitrovica.org](http://www.mediation-mitrovica.org)

# Vlerësimi i Bashkëpunimit Ekonomik Ndëretnik në Kosovë

Në fokus: Rajoni i Mitrovicës, Prishtina dhe Graçanica

Ky hulumtim u realizua në kuadër të projektit “Nxitja e Kuptimit dhe Zhvillimit të Ndërsjellë” të financuar nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA

Përmbajtja dhe mendimet e shprehura në këtë dokument janë përgjegjësi të Autorit (ëve) dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Ambasadës Zvicerane në Kosovë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet në ndonjë formë dhe mënyrë pa leje.

Mars 2021

# Përmbajtja

---

Përmbledhje .....	4
Gjetjet kryesore:.....	5
Metodologjia .....	7
Hyrje .....	8
Seksioni 1.....	9
Pasqyrë e ekonomisë së Kosovës.....	9
Efektet e Dialogut në bashkëpunimin ekonomik dhe integrimin .....	10
Ekonomia në Prishtinë dhe komunat me shumicë shqiptare në rajonin e Mitrovicës .....	13
Ekonomia në zonat me shumicë serbe në Kosovë dhe ndikimi në bashkëpunimin ndëretnik .....	15
Sektori privat dhe mangësitë e tij.....	16
Konteksti i ndryshëm institucional për Kosovën Veriore dhe Graçanicën .....	17
Klima sfiduese e investimeve.....	20
Seksioni 2.....	22
Gjendja aktuale e bashkëpunimit ndëretnik dhe pengesat kryesore .....	22
Si ndikojnë në bashkëpunim gjuha, perceptimi i sigurisë dhe politika .....	29
Hendeku gjuhësor në rritje .....	29
Perceptimi i sigurisë ndikon në lëvizje .....	30
A është bashkëpunimi ekonomik i qëndrueshëm ndaj ndërhyrjeve politike?.....	32
Mangësitë e procesit të integrimit .....	33
Ekonomia emocionale .....	34
Mungesa e mbështetjes institucionale për bashkëpunimin ekonomik .....	38
Oda Ekonomike e Kosovës - frika nga e panjohura .....	40
Mbështetja e akterëve të tjerë joqeveritarë .....	41
PËRFUNDIMI: .....	43
REKOMANDIME: .....	43

# Përmbledhje

---

Marrëdhëniet në mes të shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës kanë qenë të tensionuara për dekada. Antagonizmat vazhdojnë nga trendet e diktura nga elitat politike dhe akterët e tjerë të shoqërisë. Sidoqoftë, ato mund të kundërshtohen nga rritja e komunikimit ndëretnik - qëndrueshmëria e të cilit mund të vendoset përmes bashkëpunimit ekonomik të bazuar në interes.

Fatkeqësisht, niveli i bashkëpunimit ekonomik në mes të bizneseve të drejtuara nga shqiptarët dhe bizneseve të drejtuara nga serbët është i pamjaftueshëm për të anuluar dëmin e rrëfimeve toksike. Paradoksisht, një impuls pozitiv nga liderët politik dhe akterët e shoqërisë është i nevojshëm për të katalizuar integrimin ekonomik, sygjeron ky hulumtim i realizuar nga Qendra për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve.

Qëllimi i këtij hulumtimi është të oftojë një pasqyrë të gjendjes aktuale, sfidave, nevojave dhe potencialeve të bashkëpunimit ndëretnik në nivelin e biznesit në rajonin e Mitrovicës<sup>1</sup>, Graçanicës dhe Prishtinës.

Projekti pjesë e të cilit është ky hulumtim, ka për qëllim të promovojë bashkëpunimin ekonomik ndëretnik dhe të raportojë në fushat që kërkojnë ndërhyrje. Gjetjet kryesore të hulumtimit do të prezantohen në një ngjarje të organizuar nga ADRC ku komunitetet do të përpilojnë ndërhyrje zhvillimore në shkallë të vogël për të adresuar çështjet e identifikuara nga ky raport.

Ky punim është i organizuar si në vijim: Seksioni 1 ofron një përmbledhje të situatës së përgjithshme socio-ekonomike të Kosovës dhe posaçërisht në komunat e rajonit të Mitrovicës, Prishtinës dhe Graçanicës. Seksioni 2 shtjellon bashkëpunimin ekonomik, paraqet dhe analizon gjetjet kryesore të bashkëpunimit në mes të komuniteteve, pengesat për të bërë biznes dhe mundësitë për përmirësuar bashkëpunimin ekonomik ndëretnik. Seksioni i fundit paraqet përfundimet dhe rekomandimet e punimit.

---

<sup>1</sup> Rajoni i Mitrovicës përfshin komunat: Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok, Mitrovicë e Jugut, Skenderaj dhe Vushtrri

## Gjetjet kryesore:

---

- Prishtina mbetet rajoni më i zhvilluar, ndërsa Mitrovica është një nga rajonet më të varfura në Kosovë. Prej kur Trepça humbi rolin e saj dominues ekonomik si punëdhënësi më i madh në rajon, Mitrovica nuk arriti të kalojë me sukses në sektorët tjerë ekonomikë;
- Sektori privat në komunitetet me shumicë serbe është më pak i zhvilluar në krahasim me zonat tjera në Kosovë. Arsyet mund të gjenden në vijim:
  - mungesa e investimeve në sektorin privat për shkak të paqëndrueshmërisë politike, mosmarrëveshjeve të pazgjidhura politike dhe mosbesimit ndaj sistemit institucional;
  - mungesa e motivimit për t'u inkuadruar në sektorin privat për shkak të përceptimit të mundësive të mjaftueshme të punësimit në sektorin publik në zonat e populluara nga serbët;
  - vështirësitë për tu integruar ekonomikisht në Kosovë për shkak të pengesave gjuhësore, nacionalizmit ekonomik dhe pengesave administrative të shkaktuara nga procesi jo i plotë i integritimit;
  - vështirësitë për të eksportuar në Serbi për shkak të mungesës së tyre të konkurrencës dhe masave jo-tarifore në fuqi;
- Bizneset e drejtuara nga serbët nga Graçanica janë më të integruara ekonomikisht në ekonominë e Kosovës dhe kanë një shkallë më të lartë të bashkëpunimit me bizneset e drejtuara nga shqiptarët, në krahasim me bizneset e drejtuara nga serbët në Veriun e Kosovës<sup>2</sup>. Megjithëse marrëveshjet e udhëhequra nga Brukseli kontribuan në integrimin ekonomik të bizneseve nga komunat me shumicë serbe të veriut të Kosovës, ndërveprimi i tyre biznesor mbetet kryesisht i përqëndruar në tregtinë me Serbinë. Arsyet kryesore për dallimet e identifikuar në mës të Graçanicës dhe komunave veriore kanë të bëjnë me:
  - integrimin jo të plotë institucional të katër komunave veriore në sistemin juridik të Kosovës;
  - lidhja territoriale e komunave veriore me Serbinë. Gjegjësisht, megjithëse ekziston një kërkesë e madhe për mallra të prodhuara në Serbi në të gjitha zonat me shumicë serbe në të gjithë Kosovën, lidhja territoriale e Veriut të Kosovës me Serbinë ofron një mundësi për bizneset e drejtuara nga serbët dhe për komunitetin për të marrë mallra në Serbi ose në tregun e gjerë të Kosovës. Tarifa 100% nuk ndikoi shumë në qasjen e produkteve serbe në Veriun e Kosovës pasi që bizneset mund të përdornin rrugë alternative për të shmangur IBM dhe Doganat e Kosovës;
- Bizneset e drejtuara nga serbët në Kosovë janë më të interesuar për bashkëpunim me bizneset e drejtuara nga shqiptarët sesa anasjelltas. Arsyet kryesore qëndron në madhësinë e tregjeve. Bizneset e drejtuara nga serbët kanë interes më të lartë për të marrë pjesë në tregun e gjerë të Kosovës, si në drejtim të shitjes së produktit të tyre tek shumica e popullatës, poashtu edhe në blerjen e mallrave dhe shërbimeve pasi që tregu ka më shumë për

---

<sup>2</sup> Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, Zveçan dhe Zubin Potok

të ofruar. Në anën tjetër, pronarët e bizneseve shqiptare shfaqin interes më të ulët për të depërtuar në tregun e vogël të komunave me shumicë serbe. Për më tepër, sektori privat i dobët në këto zona nuk ka shumë për të ofruar për tregun e gjerë të Kosovës;

- Barriera gjuhësore mbetet një nga pengesat më të mëdha në krijimin e komunikimit dhe bashkëpunimit ekonomik;
- Për shkak të marrëdhënieve të dobëta ndëretnike dhe pengesës gjuhësore, shumë shqiptarë dhe serbë nuk ndihen plotësisht të sigurtë për të lëvizur lirshëm në zonat e dominuara nga komuniteti etnik i kundërt. Kjo pengesë në krijimin e bashkëpunimit ka më shumë nuanca pasi që ka zona me shumicë serbe të përceptuara si të sigurta nga shqiptarët (Graçanica) dhe zona të përceptuara si më pak të sigurta (katër komunat në pjesën veriore). E njëjta gjë qëndron për komunitetin serb. Prishtina përceptohet si më e sigurtë për të lëvizur lirshëm sesa Vushtrria, Skenderaji dhe Mitrovica e Jugut. Ky dallim në përceptimin e sigurisë në mes të rajonit të Mitrovicës dhe Prishtinës dhe Graçanicës është si rezultat i konfliktit 1998-1999, i cili ishte më intensiv në rajonin e Mitrovicës sesa në Prishtinë dhe për shkak të pasojave të tensioneve politike me dekada të gjata të cilat kryesisht kishin epiqendrën në Mitrovicë. Veriu i Kosovës përceptohet si rezultat ku takohen dy nacionalizmet;
- Fakti që shumë prej bizneseve të drejuara nga serbët mbeten të paregjistruara dhe veprojnë jashtë sistemit ligjor të Kosovës, duke përfshirë situatën e brishtë politike, ndikon në vendimin e kompanive të drejuara nga shqiptarët për të mos hyrë në bashkëpunim zyrtarë me kompanitë nga katër komunat veriore;
- Ekonomia emocionale apo nacionalizmi ekonomik është i pranishëm në një masë të caktuar në mesin e konsumatorëve. Sipas hulumtimit, 15 nga 63 të anketuar nga intervistat dhe diskutimet në tryeza të rrumbullakëta shprehën këtë besim duke dhënë shumë shembuj empirikë. Rezultati, megjithatë, tregoi gjithashtu se bizneset e drejuara nga shqiptarët dhe serbët, si çdo biznes tjetër, janë kryesisht të orientuara drejt fitimit. Pavarësisht kësaj, njërëzit e biznesit drejtohen nga preferencat ekonomike të konsumatorëve, gjë që i bën furnizuesit të sillen në përputhje me kërkesën e tregut;
- Nuk ka mbështetje të strukturuar institucionale nga niveli qëndror për të rritur bashkëpunimin ekonomik në mes të bizneseve të drejuara nga shqiptarët dhe serbët në Kosovë. Në anën tjetër, edhe pse institucionet lokale kanë kompetenca të kufizuara për të mbështetur bashkëpunimin ekonomik ndëretnik, përpjeket e tilla kanë tendencë të politizohen. Në fund, megjithëse tensionet politike mund të ndalojnë përkohësisht bashkëpunimin ekonomik, nuk ka politika sistemike për të dekurajuar bashkëpunimin ekonomik ndëretnik;
- Covid-19 lë pasojat të rënda për ekonominë botërore, përfshirë edhe Kosovën. Për shkak të strukturës ekonomike të Kosovës, e cila bazohet në tregti dhe shërbime, pasojat ekonomike janë edhe më shkatërruese. Zvogëlimi i shkëmbimit ekonomik në përgjithësi ndikoi edhe më negativisht në bashkëpunimin ndëretnik tashmë të ulët;

# Metodologjia

---

Hipoteza kryesore e hulumtimit është se në zonat pas konfliktit, ndërtimi i lidhjeve të forta ekonomike dhe ndërvarësia në mes të palëve konfrontuese, përveç pasojave pozitive ekonomike, sjell gjithashtu mundësi për ndërtimin e paqes. Nga njëra anë, ndërvarësia ekonomike e bën konfliktin jo fitimprurës, si në nivelin individual ashtu edhe në atë kombëtar. Në anën tjetër, lidhjet e ngushta ekonomike dhe bashkëpunimi ekonomik vijnë me ripërtëritjen e pashmangshme të lidhjeve të komunikimit në mes të anëtarëve të grupeve etnike të kundërta. Kjo, nga ana tjetër, është esenciale për të thyer paragjykimet dhe për të humanizuar “anën tjetër”. Ndërveprimi dhe komunikimi më një palë kontestuese janë elemente themelore të çdo projekti paqeje. Ajo që dallon projektet e lidhjes ekonomike nga projektet e tjera të paqes është komponenti i fortë i qëndrueshmërisë që i përket komunikimit dhe ndërveprimit në mes të palëve të konfrontuara.

Ky hulumtim i realizuar ndërmejt korrikut 2020 dhe shkurtit 2021, bazohet në analizën e kërkimeve në tavolinë dhe metodave cilësore. Kërkimi në tavolinë përfshin konsultimin e studimeve të disponueshme socio-ekonomike mbi ekonominë e Kosovës, ekonominë në zonat e populluara nga serbët dhe studime në lidhje me marrëdhëniet ndëretnike dhe bashkëpunimin në mes të komuniteteve në Kosovë. Kjo fazë e hulumtimit gjithashtu konsultoi marrëveshjet teknike dhe politike të arritura në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe analizoi efektet e tyre në integrimin ekonomik të komunitetit serb në Kosovë.

Kërkimi cilësor përbëhet nga intervista të thella me akterë të ndryshëm dhe tryeza të rrumbullakëta të zhvilluara me profesionistë të cilët janë të angazhuar në bashkëpunimin ekonomik. Intervistat u zhvilluan me 33 përfaqësues të bizneseve<sup>3</sup> (19 sipërmarrës serb and 14 sipërmarrës shqiptarë). Përveç kësaj, intervistat u zhvilluan me Ministrinë e Bujqësisë dhe Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, përfaqësues të Komunës së Prishtinës<sup>4</sup> dhe Komunës së Mitrovicës së Jugut, përfaqësues nga Oda Ekonomike e Kosovës dhe grupeve të interesit.<sup>5</sup> Pyetjet drejtuar palëve kishin për qëllim të vlerësonin shkallën aktuale të bashkëpunimit ekonomik ndëretnik dhe gatishmërinë e komuniteteve serbe dhe shqiptare për të punuar së bashku; ato gjithashtu shqyrtuan sfidat dhe pengesat kryesore me të cilat përballen bizneset gjatë bashkëpunimit me komunitetet e tjera. Katër tryeza të rrumbullakëta u zhvilluan me profesionistë në fushat përkatëse nga rajoni i Mitrovicës, Prishtinë dhe Graçanicë. Në total, 19 profesionistë

---

<sup>3</sup> Barnatore në Mitrovicën e Veriut; Etno Kuca në Graçanicë; Fermer në Zubin Potok; Kompani ndërtimore në Mitrovicën e Veriut; Kombinat (kompani hotelierike) në Mitrovicën e Veriut dhe Zveçan; Prodhues dhe distributor të mjaltit në Zveçan; Furrë në Zveçan; Kompani përpunuese në Graçanicë; Sallon i mobiljeve Stanic në Zubin Potok; Sallon i mobiljeve Simpo në Zubin Potok; Supermarket në Zubin Potok; Kompani hotelierike në Leposaviq, Kompani hotelierike në Zubin Potok; Kompani hotelierike Vez në Mitrovicën e Veriut; Sallon i mobiljeve dhe zdrukhtari në Zveçan; Transportues privat në Mitrovicën e Veriut; Pompë e benzinës në Zveçan; Verari në Leposaviq; Kooperativë bujqësore Zveçan; Kompania "Aurora"; Kompania ndërtimore Bunjamin në Mitrovicë; Kompania ndërtimore Rukolli në Skenderaj; Kompania "Araf"; Qendra Bonevet; Polymath Labs; Kolegji Riinvest; Kompania Sheraton; Kompania TrePharm; Kompania ITBM; Shitorja e bizhuterive Goldsmith në Skenderaj; Pruthi Sport; Kompania SME në Prishtinë; Villastar.

<sup>4</sup> Zyra Ekonomike dhe Zyra për Kthim dhe Komunitete, Komuna e Prishtinës

<sup>5</sup> ARDA në Mitrovicën e Veriut; Qendra e Inovacionit në Prishtinë; Shoqata Kosovare për Marketing të Veshmbathjeve; Fondi Kosovar për Garanci Kreditore; Instituti për Zhvillimin Ekonomik Territorial



morën pjesë në këto diskutime. Ata mbështetën hulumtimin duke analizuar gjetjet dhe disa nga specifikat kryesore në lidhje me dallimet në kontekstin e komunave të synuara.

## Hyrje

---

Përveç viktimave dhe dëmeve materiale, konfliktet ndëretnike lënë pasoja shkatërruese: shoqëri të ndara që nuk komunikojnë dhe urrejtje që krijon bazën për ndërtimin e narrativave kombëtare të njëanshme me potencial të madh për të çnjerëzuar palën tjetër. Urat e prishura të komunikimit në mes të grupeve etnike, narrativat e njëanshme dhe çnjerëzimi janë kontribuesit kryesorë në vazhdimin e konfliktit dhe ringjalljen e tij të mundshme. Përkundër kësaj, forcimi i bashkëpunimit në mes të anëtarëve të shoqërisë të të dy palëve të kundërta lehtëson komunikimin e qëndrueshëm ndërmjet anëtarëve të grupeve etnike. Kjo është esenciale për të thyer paragjykimet dhe narrivat e njëanshme në planin afatgjatë. Kjo gjë u vërtetua nga hulumtimi në lidhje me nivelin e komunikimit në mes të serbëve dhe shqiptarëve në qytetin e ndarë të Mitrovicës, të realizuar nga Qendra për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve. Sondazhi që përfshiu të dy grupet etnike, përkatësisht serbët dhe shqiptarët, dëshmoi kauzalitet të drejtëpërdrejtë midis shkallës së komunikimit me “anën tjetër” dhe shkallës së distancës etnike ndaj “anës tjetër”. Shqiptarët që komunikojnë më shumë me anën tjetër, pavarësisht nëse ata punojnë ose bëjnë tregti me serbët, kanë distancë më të ulët etnike ndaj atij grupi etnik dhe anasjelltas. Një aspekt tjetër i komunikimit ndëretnik në Mitrovicë i shfaqur në hulumtimin e ADRC-së është se komunikimi dhe ndërveprimi me “anën tjetër” ndodh kryesisht nga interesi ekonomik ose nevojat e biznesit.<sup>6</sup>

Prandaj, mund të postulohet që normalizimi ekonomik i marrëdhënieve në nivelin e komunitetit mund të kontribuojë gjithashtu në normalizimin politik të marrëdhënieve dhe ndryshimin e diskursit të elitave politike.


---

<sup>6</sup> [Qendra për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve, “Përtej Urës: Simbolizmi i Lirisë së Lëvizjes dhe Sigurisë”, 2017](#)

# Seksioni 1.

## Pasqyrë e ekonomisë së Kosovës

Sipas treguesve makroekonomikë, ekonomia e Kosovës ka rritje të vazhdueshme në 20 vitet e fundit. Të dhënat e Bankës Botërore të paraqitura në grafikun më poshtë, tregojnë se BPV për kokë banori u rrit nga \$ 1,087 në \$ 4,417 prej vitit 2000 deri më 2019.<sup>7</sup>



Figurë: BPV për kokë banori në Kosovë 2000 - 2019 (Burimi: Banka Botërore)

Sipas pasqyrës së Bankës Botërore për ekonominë e Kosovës, meqenëse Kosova ka një bazë më të ulët ekonomike, rritja ka qenë më e lartë se e fqinjëve të saj në dekadën e kaluar, por, kjo rritje nuk ka qenë e mjaftueshme për të siguruar punë të mjaftueshme, veçanërisht për gratë dhe të rinjtë, ose për të zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme nivelet e larta të papunësisë. Modeli i rritjes mbështetet kryesisht në remitencat për të furnizuar konsumin e brendshëm, por kohët e fundit është zhvendosur në më shumë investime dhe rritje të drejtuar nga eksporti.<sup>8</sup>

Gjatë dy dekadave të fundit, pavarësisht normës së qëndrueshme të rritjes, shkalla e papunësisë së bashku me treguesit e tjerë të tregut të punës - mbetet më e dobëta në rajonin e Ballkanit Perëndimor, pasi më pak se një e treta e popullatës së rritur mban një vend pune - me gati nëntë në dhjetë gra që nuk punojnë dhe rreth pesëdhjetë përqind e të rinjëve të vendit të papunë. Kosova ka popullsinë më të re në Evropë. Të rinjtë (nën 15 vjeç) përbën 25.7% të popullatës, ndërsa moshë e punës (15-64) përbën 67.6%. Vetëm tetë përqind e popullatës së Kosovës janë të moshuar, krahasuar me 19% Bashkimin Evropian.<sup>9 10</sup>

7

<https://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.PCAP.CD?end=2019&locations=XK&start=2000&view=chart>

<sup>8</sup> <https://www.worldbank.org/en/country/kosovo/overview>

<sup>9</sup> Banka Botërore, "Diagnostifikimi i Punës Kosovë", 2017

<sup>10</sup> Popullsia totale e vlerësuar në Kosovë është 1.8 milion. Regjistrimi i popullsisë në vitin 2011, i realizuar nga autoritetet e Kosovës u bojkotua nga shumica e komunitetit serb. Vlerësohet se rreth 120.000 serb jetojnë në Kosovë.

Sektorët ekonomikë që janë punëdhënësit më të mëdhenj janë: tregtia me 17.0%; ndërtimtaria me 12.6%; prodhimi me 11.9%; dhe arsimit me 10.0%. Ndërsa sektorët tjerë, kanë një përqindje më të ulët.

Sipas raportit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2018, aktivitetet e mëposhtme ekonomike kontribuojnë më së shumti në BPV-në e Kosovës: Tregtia me shumicë dhe pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave me 13%, Prodhimi me 11.3%, Ndërtimtaria me 8.7%, Administrata publike, mbrojtja dhe sigurimi i detyrueshëm shoqërorë me 7.8%, Aktivitetet e pasurive të paluajtshme me 7.4%, Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi me 7.2%.<sup>11</sup>

Përveç treguesve zyrtarë makroekonomikë me të cilët institucionet e Kosovës regjistrojnë dhe paraqesin gjendjen e ekonomisë formale, ka vlerësime se madhësia e ekonomisë joformale apo ekonomisë në hije përbën rreth 30% të BPV-së së Kosovës ose rreth 1.8 miliardë euro. Gjithashtu, shkak kryesor i ekonomisë në hije konsiderohet të jetë papunësia e lartë.<sup>12</sup>

## Efektet e Dialogut në bashkëpunimin ekonomik dhe integrimin

Kur bëhet fjalë për kontekstin politik në lidhje me temën e këtij hulumtimi, është e rëndësishme të përmendet se procesi i vazhdueshëm i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë ndikon në integrimin ekonomik dhe administrativ të komunave me shumicë serbe, si dhe në marrëdhëniet ndëretnike.

Përkatësisht, pas një mosmarrëveshje të gjatë politike në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe status quo-së të komunave veriore në Kosovë, BE inicoi dialogun në mes të palëve kontesuese në vitin 2011 për të zgjidhur çështjet teknike dhe politike të cilat po pengonin marrëdhëniet. Në fazën e parë të negociatave teknike, gjithsej 6 marrëveshje që ndër të tjerash, kishin për qëllim rregullimin e shkëmbimit ekonomik, u arritën në 2011 dhe 2012: Liria e lëvizjes, Regjistri civil, Vulat doganore, Njohja e diplomave, IBM<sup>13</sup>, Përfaqësimi rajonal<sup>14</sup>.

Pas marrëveshjeve teknike të arritura, marrëveshja e parë politike e quajtur “Marrëveshja e Parë e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve” (e njohur si marrëveshja e Brukselit) u arrit në 2013. Kjo marrëveshje përcaktoi integrimin e Veriut të Kosovës në sistemin institucional të Kosovës<sup>15</sup> dhe u pasua nga më shumë marrëveshje të arritura në lidhje me integrimin e serbëve të Kosovës dhe bashkëpunimin ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë - më e rëndësishmja, marrëveshja për krijimin e Asociacionit/Komunitetit të Komunave me shumicë serbe, marrëveshja për sigurimin e automjeteve si dhe memorandumit i mirëkuptimit në mes të Odës Ekonomike të Serbisë dhe Odës Ekonomike të Kosovës.

Në memorandumin e tyre të parë të nënshkruar në 2013, ndër të tjerash, të dy odat u pajtuan të shkëmbejnë informacione dhe të analizojnë tregjet; të mbështesin ndërmarrjet e tyre anëtare në bashkëpunime të ndryshme tregtare dhe ekonomike; të organizojnë ngjarje të përbashkëta dhe të

<sup>11</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, “Bruto Produkti Vendor 2008-2018”, 2019

<sup>12</sup> British Council, “Studimi i Sfidave që Ndalojnë Zhvillimin e NMVM-ve në Kosovë”, 2018


<sup>13</sup> Beogradi i referohet kësaj shkurtesë si Menaxhimi i Integruar i Kalimeve, ndërsa Prishtina i referohet si Menaxhimi i Integruar i Kufirit

<sup>14</sup> Të gjitha marrëveshjet mund t'i gjeni në: <http://www.kim.gov.rs/eng/pregovaracki-proces.php>

<sup>15</sup> <http://www.kim.gov.rs/eng/p03.php>

promovojnë mundësi partneriteti.<sup>16</sup> Në aneksin e këtij memorandumi të nënshkruar në vitin 2013, odat u pajtuan më tej për të promovuar dhe bashkëpunuar në azhurnimin e mekanizmave alternative të zgjidhjes së kontesteve me qëllim të zgjidhjes së kontesteve tregtare në mes të ndërmarrjeve të tyre të antarësuar.<sup>17</sup> Në fund, dy anekse shtesë u nënshkruan në lidhje me shkëmbimin e zyrtarëve ndërlidhës në zyrat e njëri-tjetrit;<sup>18</sup> dhe një aneks lidhur me angazhimin për të rivendosur trafikun postar në mes të zyrave të Postës së Serbisë dhe Kosovës.<sup>19</sup>

Si rezultat i turbulencës politike në mes të palëve të shkaktuara nga akuzat e ndërsjella për vonesën e qëllimshme të zbatimit të marrëveshjeve dhe lobimin e Serbisë kundër aplikimit të Kosovës për anëtarësim në INTERPOL, në nëntor 2018, Kosova paraqiti tarifën 100% për produktet nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina. Ky veprim e ndaloi dialogun e lehtësuar nga BE-ja për 18 muaj, ndërsa ai rifilloi në mes të vitit 2020 pas ndërhyrjes së përbashkët të Francës dhe Gjermanisë.<sup>20</sup> Ky vendim gjithashtu shkaktoi pothuajse çrregullim të plotë të eksportit të Serbisë në Kosovë. Siç shihet në figurën më poshtë, eksporti i Serbisë në Kosovë u rrit nga 260 milion euro në 2010 në 450 milion euro në 2017, dhe më në fund pati një rënie të pjerrët në vitin 2019.



Figurë: Shkëmbimi ekonomik në mes të Serbisë dhe Kosovës 2010 - 2019 (Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës)

<sup>16</sup> [Memorandumi i Mirëkuptimit në mes të Odës Ekonomike dhe Industrisë së Serbisë dhe Odës Ekonomike të Kosovës, e nënshkruar në Bruksel, 2013](#)

<sup>17</sup> [Shtojcë e Memorandimit të Mirëkuptimit në mes të Odës Ekonomike dhe Industrisë së Serbisë dhe Odës Ekonomike të Kosovës, e nënshkruar në Bruksel, 2013](#)

<sup>18</sup> [Shtojcë Nr.2.1 e Memorandimit të Mirëkuptimit në mes të Odës Ekonomike dhe Industrisë së Serbisë dhe Odës Ekonomike të Kosovës, e nënshkruar në Bruksel, 2015](#)

<sup>19</sup> [Aneks Nr.3 i Memorandimit të Mirëkuptimit në mes të Odës Ekonomike dhe Industrisë së Serbisë dhe Odës Ekonomike të Kosovës, e nënshkruar në Bruksel, 2015](#)

<sup>20</sup> Sidoqoftë, duhet të theksohet se dialogu i udhëhequr nga BE rifilloi gjithashtu si “pasojë pozitive” e presionit të Administratës Amerikane ndaj qeverisë së Kosovës për të hequr reciprocitetin për shkak të interesit të tyre të veçantë për të ndjekur procesin e negociatave i cili do të çojë në marrëveshjen e Uashingtonit në shtator 2020.

Dialogu rifilloi menjëherë sapo koalicioni i ri qeveritar i themeluar në qershor 2020 anuloi vendimin e paraqitur për masat e reciprocitetit<sup>21</sup>, të cilat rezultuan në rivendosjen e shkëmbimit ekonomik dhe dialogun me Serbinë - njëra e lehtësuar nga BE-ja dhe tjetra e lehtësuar nga SHBA.

Në shtator 2020, nën lehtësimin e Administratës së SHBA-së, Beogradi dhe Prishtina nënshkruan individualisht dy marrëveshje paksë të ndryshme të pranuar në letrat e ndara të nënshkruara nga presidenti i atëhershëm i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump. Dokumentet e nënshkruara nga palët u quajtën Marrëveshja e Normalizimit Ekonomik<sup>22</sup>, dhe ajo kompletoi dokumentet e nënshkruara më parë lidhur me linjën ajrore, hekurudhën dhe autostradën (Autostrada e Paqes). Marrëveshja përmban pika në lidhje me kryerjen e një studimi të fizibilitetit për qëllime të ndarjes së liqenit të Ujmanit si furnizim i besueshëm i ujit dhe energjisë; studim fizibiliteti për lidhjen e infrastrukturës hekurudhore Beograd-Prishtinë me një port të thellë detar në Adriatik; Bashkëpunimi me Koorporatën Ndërkombëtare të SHBA-së për Zhvillim Financiar, e cila do të hapte zyrat e saj në Beograd, me qëllim të funksionalizimit të Autostradës së Paqes, lidhjeve hekurudhore, duke siguruar financim për të mbështetur ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM); anëtarësimi i Serbisë dhe Kosovës në “zonën mini-Schengen”.<sup>23</sup>

Sidoqoftë, siç e pranojnë edhe lehtësuesit, shumë nga marrëveshjet e arritura janë ose të pazbatuara ose përballen me sfida të vazhdueshme në zbatim, siç është posaçërisht me rastin e Marrëveshjes për Përfaqësimin Rajonal. Sipas Përfaqësuesit Special të BE-së për dialogun në mes të Beogradit dhe Prishtinës, Miroslav Lajcak, dialogu i lehtësuar nga BE është korniza e vetme për zgjidhjen e çështjeve të zbatimit, dhe pa një kornizë të tillë, çështjet do të “trajtoheshin në media” dhe në mënyre të pashmangshme do të ngriteshin tensionet.

Kjo është pikërisht ajo që është e rëndësishme të theksohet - marrëdhëniet politike në mes të qeverive në Beograd dhe Prishtinë dhe statusi i dialogut vazhdojnë të kenë një ndikim në bashkëpunimin jo vetëm në mes të dy palëve, por edhe në mes të bizneseve të drejtuara nga serbët dhe shqiptarët në Kosovë dhe integritit ekonomik të zonave të populluara nga serbët. Më shumë detaje mbi problemet praktike që u shfaqën pas fillimit të integritit të Veriut të Kosovës që ndikojnë në integritimin ekonomik do të shtjellohen më tej në Seksionin 2 të këtij hulumtimi.

---

<sup>21</sup> Herët në prill 2020, Kryeministri Albin Kurti shfuqizoi masën e tarifës 100% dhe e zëvendësoi atë me masën e reciprocitetit. Vendimi hoqi taksat, por bëri që bizneset serbe të mos ishin në gjendje të vazhdonin importin pasi u kërkohej të përdornin dokumentacionin dhe frazat e përcaktimit të statusit siç janë "Republika e Kosovës".

<sup>22</sup> [Marrëveshja për Normalizimin Ekonomik në mes të Kosovës dhe Serbisë, e nënshkruar në Uashington, 2020](#)

<sup>23</sup> <https://www.euronews.com/2019/11/11/western-balkan-leaders-plot-their-own-mini-schengen-zone>

## Ekonomia në Prishtinë dhe komunat me shumicë shqiptare në rajonin e Mitrovicës

Kosova është e ndarë administrativisht në shtatë rajone dhe 38 komuna, Prishtina është kryeqyteti dhe qendra ekonomike e Kosovës. Përderisa Prishtina është qyteti me rritjen më të shpejtë në Kosovë pas konfliktit të vitit 1999, rajoni i Mitrovicës mbetet një nga rajonet më të varfura sipas treguesve të Bankës Botërore.<sup>24</sup> Dominimin ekonomik të Prishtinës mbi rajonet e tjera të Kosovës e konfirmon edhe sondazhi i publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës lidhur me investimet ekonomike të Kosovës në vitin 2019. Nga të gjitha investimet e bëra në Kosovë, 48.86% janë investime nga rajoni i Prishtinës, ndërsa në anën tjetër, bizneset e Rajonit të Mitrovicës kontribuan në investimet e përgjithshme në 2019 me vetëm 7.39%.<sup>25</sup>

Struktura ekonomike e Prishtinës është e orientuar kryesisht në tregti dhe shërbime. Bazuar në të dhënat e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, nga 13.306 biznese të regjistruara, 54% e tyre janë të regjistruar në sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë, hotele dhe restorante, 15% me transport, magazinim dhe komunikim, 8% me patundshmëri dhe vetëm 4% me veprimtari përpunuese.<sup>26</sup>

Aktivitetet ekonomike të shërbimit që përbëjnë avantazhin konkurrues të Prishtinës janë të përqendruara kryesisht në hapësirën urbane të qendrës së qytetit dhe zonat urbane të lagjeve: "Dardania", "Ulpiana", "Kodra e Diellit", "Lakërishta", "Qendra" dhe "Aktashi". Në zonën e Qendrës, dominojnë institucionet administrative të pushteti qendror dhe lokale, hotelet, restorantet bankat, objektet kulturore, lokalet tregtare me pakicë dhe selitë e zyreve të bizneseve të ndryshme. Në zonat tjera të urbanizuara në kuadër të veprimtarive terciare ushtrohet aktiviteti i llojllojshëm i shërbimeve duke dominuar tregtia me pakicë dhe restorantet. Në vitet e fundit, Prishtina ka luajtur një rol vendimtar në ofrimin e mundësive për mbajtjen e panairëve në qendër të qytetit, duke mbështetur kështu promovimin e bizneseve të vogla, artizanatet dhe bizneset familjare.<sup>27</sup>

Nyjat kryesore ekonomike në Komunën e Prishtinës shtrihen në aksin rrugor Prishtinë - Fushë Kosovë dhe Prishtinë - Ferizaj. Plani dhe Strategjia e Zhvillimit Urban të Prishtinës për vitet 2004/2020+ definoi lokacionet për veprimtari ekonomike dhe jo-ekonomike si: unazat e qytetit, autostrada Prishtinë - Merdare, nyjat strategjike për zhvillim të ekonomive shërbyese (Prishtinë - Aeroport), zona industriale ekzistuese prej 60ha, zona industriale prej 600 ha si dhe Prishtina e Re me një sipërfaqe prej 1000 ha. Këto hapësira ofrojnë mundësi shtesë për zhvillimin e biznesit sipas standardeve më të mira.<sup>28</sup>

Rajoni i Mitrovicës ndodhet në pjesën veriore të Kosovës. Ai përbëhet nga shtatë komuna, tri prej të cilave janë me shumicë shqiptare<sup>29</sup>, dhe katër komuna më shumicë serbe.<sup>30</sup> Dekada pas Luftës së Dytë Botërore, ekonomia e rajonit të Mitrovicës ishte shumë e varur nga miniera e Trepçës, e

<sup>24</sup> Shkalla e varfërisë në Prishtinë është 16%, ndërsa në rajonin e Mitrovicës shkalla e varfërisë është 44%. Referenca: [Banka Botërore, "Diagnostikimi Sistemik i Vendit Republika e Kosovës", 2017](#)

<sup>25</sup> [Agjencia e Statistikave të Kosovës, "Statistikat e Investimeve në Ndërmarrje 2019", 2020](#)

<sup>26</sup> <https://Pristinaonline.com/drejtjorite/ekonomi-dhe-zhvillim-lokal/ekonomia>

<sup>27</sup> [Strategjia e Zhvillimit Lokal Ekonomik për Komunën e Prishtinës 2013-2016](#)

<sup>28</sup> Ibid.

<sup>29</sup> Mitrovica e Jugut, Skenderaj dhe Vushtrri

<sup>30</sup> Leposaviq, Mitrovica e Veriut, Zveçan, Zubin Potok. Në këtë dokument referohen si Veriu i Kosovës.

cila në kulmin e saj në 1988 kishte të punësuar pothuajse 23.000 punëtorë.<sup>31</sup> Periudha e viteve 90-ta të shekullit të kaluar solli konfliktin dhe tranzicionin e sistemit ekonomik, ku Trepça humbi pjesën më të madhe të rëndësisë së saj ekonomike në këtë rajon. Tranzicioni i pasuksesshëm ekonomik shënon periudhën pas konfliktit dhe rajoni mbetet i pazhvilluar dhe i ndarë përgjatë vijave etnike.

Përbërja e sektorit privat në zonat e rajonit me shumicë shqiptare dhe me shumicë serbe është shumë e ngjashme sa i përket gjashtë sektorëve më të mëdhenj të aktiviteteve edhe pse pjesa e tyre ndryshon. Prodhimi, tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave dhe ndërtimtaria përbëjnë pjesën më të madhe të sektorit privat të rajonit të Mitrovicës.<sup>32</sup>

Sa i përket strukturës ekonomike në komunat me shumicë shqiptare të rajonit të Mitrovicës, sipas bazës së të dhënave të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), sektori privat i Mitrovicës së Jugut dominohet nga sektorët e tregtisë; ndërtimtaria; prodhimi (sidomos i ushqimit), dhe bujqësia dhe pylltaria. Të dhënat tregojnë dallime të vogla në përbërjen e sektorit privat nëpër komunat e këtij nënrajonit. Në Skenderaj, ndërtimtaria (24%); prodhimi (15%); tregtia (14%); dhe bujqësia dhe pylltaria (12%) përbëjnë pjesën më të madhe të sektorit privat. Në Vushtri, prodhimi (24%) është sektori më i madh, i ndjekur nga tregtia (21%); ndërtimtaria (14%) dhe bujqësia dhe pylltaria (10%). Në Mitrovicën e Jugut, sektori i bujqësisë dhe pyjeve përfshin vetëm 5% të sektorit privat, ndërsa prodhimi (19%), tregtia (18%) dhe ndërtimtaria (15%)<sup>33</sup>.

Sektorët e prodhimit, tregtisë me shumicë, ndërtimtarisë, shëndetësisë dhe punës sociale, shërbimeve të tjera dhe shërbimeve profesionale, shkencore dhe teknike punësuan pothuajse tre të katërtat (72%) të punëtorëve në tre komuna me shumicë shqiptare të rajonit të Mitrovicës në vitin 2014.<sup>34</sup>

Sipas sondazhit të realizuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim me NVM-të<sup>35</sup> në komunat me shumicë shqiptare të rajonit të Mitrovicës, pengesat kryesore për të bërë biznes njihen në paqëndrueshmërinë politike të rajonit, konkurrencën e padrejtë, mungesën dhe koston e furnizimit me energji, taksat e larta dhe korrupsionin.<sup>36</sup>

<sup>31</sup> [https://www.esiweb.org/pdf/esi\\_bridges\\_id\\_2\\_b.pdf](https://www.esiweb.org/pdf/esi_bridges_id_2_b.pdf)

<sup>32</sup> [UNDP, "Rajoni i Mitrovicës Vlerësimi Bazë", 2016](#)

<sup>33</sup> Ibid

<sup>34</sup> Ibid

<sup>35</sup> Ndërmarrje e vogël dhe e mesme

<sup>36</sup> [UNDP, "Rajoni i Mitrovicës Vlerësimi Bazë", 2016](#)

Ky përceptim u konfirmua gjithashtu në intervistën me një sipërmarrës nga Mitrovica e Jugut duke folur për tranzicionin e pasuksesshëm ekonomik pasi miniera e Trepçës humbi fuqinë e saj ekonomike në rajon:

---

*" Rënia e Trepçës i zuri njerëzit të papërgatitur për tranzicionin ekonomik dhe shkatërrimin ekonomik të shkaktuar nga konflikti edhe më tej krijoi vështirësi për njerëzit e rajonit të Mitrovicës për tu rikuperuar ekonomikisht. Në anën tjetër, paqëndrueshmëria aktuale politike në rajon ia pushton mendjet e njerëzve me marrëdhënie ndëretnike në vend të ideve ekonomike ".*

---

Megjithatë, janë bërë disa përpjekje nga autoritetet për të lehtësuar përparimin ekonomik në Mitrovicën e Jugut pasi ekzistojnë tre zona ekonomike të krijuara me qëllim të lehtësimit dhe promovimit të punës së bizneseve:

**Parku i Biznesit në Mitrovicë** është krijuar në vitin 2012 me sipërfaqe prej 3.5 ha. Momentalisht është i plotësuar me 24 biznese të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre biznese, duke filluar nga riciklimi i plastikës, zdrukthëtaria, prodhimin e thasëve të letrës, tekstilit, prodhime metalike etj. Nuk ka hapësira të lira për vendosje të bizneseve në këtë Park.<sup>37</sup>

**Parku Industrial në Mitrovicë** (Frashër i Vogël-Zhigovina) është krijuar në vitin 2014 me sipërfaqe prej 48 ha. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), së bashku me komunën në vitin 2014 kanë filluar investimet e para këtë park, mirëpo në mungesë të mjeteve buxhetore ende nuk është arritur finalizimi i ndërtimit të infrastrukturës fizike, megjithatë ka filluar nënshkrimi i kontratave për vendosjen e disa bizneseve, duke përfshirë veprimtari të ndryshme si: prodhimin e mobileve, prodhimin e ngjyrave dhe ngjitësve, prodhimin e dyerve nga druri, përpunimin e mbetjeve medicinale etj. Deri më tani veprimtarinë biznese ka filluar vetëm një biznes.

**Parku Industrial në Vushtrri** (Lumadh) është krijuar në vitin 2018 me sipërfaqe prej 14.86 ha. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), në vitin 2019 ka filluar investimet në Ndërtimin e infrastrukturës fizike për vendosjes së bizneseve në këtë park.<sup>38</sup>

## **Ekonomia në zonat me shumicë serbe në Kosovë dhe ndikimi në bashkëpunimin ndëretnik**

Nga 38 komunat në Kosovë, dhjetë janë me shumicë të komunitetit serb (gjashtë në jug të Kosovës dhe katër në veri të Kosovës). Katër komunat me shumicë serbe në rajonin e Mitrovicës funksiononin pothuajse plotësisht jashtë sistemit institucional të Kosovës derisa Marrëveshja e Parë e Parimeve që Rregullon Normalizimin e Marrëdhënieve në mes të Beogradit dhe Prishtinës u

---

<sup>37</sup> <https://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=2,90>

<sup>38</sup> <https://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=2,178>



nënshkrua në vitin 2013 (Marrëveshja e Brukselit).<sup>39</sup> Marrëveshja me 15 pika krijoi kushte për integrimin e këtyre katër komunave në sistemin e Kosovës. Integrimi është ende në vazhdim dhe nuk ka përfunduar plotësisht as pas shtatë viteve, pasi shumë nga marrëveshjet e arritura nuk janë zbatuar ende.

Kur bëhet fjalë për ekonominë në zonat e populluara nga serbët, është e rëndësishme të theksohet varësia e gjerë e këyre zonave nga buxheti i Qeverisë së Serbisë, përkatësisht - pagat, pensionet dhe mirëqenia sociale. Nuk ka informacion të saktë se sa njerëz janë në listat e pagave të institucioneve dhe ndërmarrjeve të drejtuara nga Serbia. Megjithatë, ka tregues të përqindjes së njerëzve të varur nga këto të ardhura. Gjegjësisht, pas përfundimit të konfliktit të vitit 1999, autoritetet serbe vazhduan të financojnë institucionet dhe ndërmarrjet publike në Kosovë, si ato që mbetën funksionale siç janë arsimiti, kujdesi shëndetësor dhe sistemi i mirëqenies sociale; poashtu edhe ato që nuk janë funksionale. Sipas hulumtimit të Institutit për Zhvillimin Ekonomik Territorial (InTER), janë rreth 8.000 të punësuar në këto institucione vetëm në katër komunat veriore.<sup>40</sup>

Duke llogaritur përfitimin financiar të këtyre të ardhurave për familjet e tyre, InTER konkludon se afërsisht 80% e banorëve të Veriut të Kosovës varen financiarisht nga buxheti i Serbisë.<sup>41</sup> Situata nuk duhet të jetë ndryshe në zonat e tjera të populluara nga serbët. Sipas sondazhit të kryer nga NGO Aktiv në zonat e populluara nga serbët në Kosovë, 26% e njerëzve të anketuar janë të punësuar nga sistemi institucional i Serbisë, ndërsa rreth 9.3% e të anketuarve janë të punësuar nga sistemi institucional i Kosovës, dhe vetëm 18.3% e njerëzve punojnë në sektorin privat<sup>42</sup>. Përveç kësaj, Serbia vazhdon të investojë në projekte zhvillimore në zonat e populluara nga serbët në Kosovë<sup>43</sup>. Kjo politikë e sigurimit të ndihmës financiare dhe shërbimeve të nevojshme të tilla si arsimiti dhe sigurimi shëndetësor rezulton nga qëllimi i qeverisë serbe për t'u përpjekur të ndalojë emigrimin e mëtejshëm të popullatës serbe nga zona pas konfliktit të Kosovës.

## Sektori privat dhe mangësitë e tij

Për më tepër, hulumtimi dëshmoi se sektori privat në zonat me shumicë serbe mbetet i pazhvilluar dhe i varur nga shpenzimet publike. Sipas studimit të botuar nga Riinvest në 2012, në kuadër të të cilit ishin intervistuar 200 biznese të drejtuara nga serbët nga të dy komunat më veriore dhe jugore me shumicë serbe, 93% e bizneseve në pronësi serbe janë biznese të vogla individuale.<sup>44</sup> Sipas studimit të lartpërmendur, kompanitë ishin të angazhuara kryesisht në ofrimin e shërbimeve dhe tregtisë (76%) para proceseve kryesore të integritit, ndërsa një numër më i vogël ishin të angazhuar në prodhim dhe përpunim (24%).<sup>45</sup> Në anën tjetër, sipas të dhënave të mbledhura në vitin 2018 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës për pjesën e aktivitetit ekonomik në Veri të Kosovës, tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve motorike dhe motoçikletat është sektori më i madh (40.4%). Ky sektor më pas ndiqet nga bujqësia, pylltaria dhe

<sup>39</sup> <http://www.kim.gov.rs/eng/p03.php>

<sup>40</sup> InTER, "Institucionet Publike të Republikës së Serbisë në Veri të Kosovës - Çfarë lloj e ardhme na pret?", 2017

<sup>41</sup> Ibid

<sup>42</sup> NGO Aktiv, "Analiza e Trendit 2020: Qëndrimet e Komunitetit Serb në Kosovë", 2020


<sup>43</sup> Ligji për Buxhetin e Republikës së Serbisë për vitin 2021

<sup>44</sup> Riinvest Institute, "Përmirësimi i Përfshirjes së Komunitetit Serb në Aktivitetet Ekonomike në Kosovë", 2012

<sup>45</sup> Ibid

peshkimi (18.6%), prodhimi (11.7%) dhe ndërtimtaria (6.4%).<sup>46</sup> Struktura e ndarjes së aktivitetit ekonomik në Graçanicë në dy vitet e fundit është disi më ndryshe. Sektori më i madh është gjithashtu tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave (32.3%), i cili pasohet nga akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit me ushqim (17.9%), prodhimi (10.2%) dhe ndërtimtaria (6.6%).<sup>47</sup>

Edhe pse i dobët, sipas të dhënave të fundit të disponueshme nga 2010, sektori privat është më i zhvilluar në Veriun e Kosovës sesa në komunat me shumicë serbe në jug për sa i përket qarkullimit vjetor. Ky studim tregon se 94% e bizneseve në komunat jugore kishin një qarkullim deri në 50.000 EUR në vit, ndërsa 52% e bizneseve të intervistuar nga komunat më veriore deklaruan se kanë një qarkullim prej mbi 50.000 EUR.<sup>48</sup> Siç sqaron një prej të anketuarve në tryezën e rrumbullakët, arsyeja për këtë mospërputhje qëndron në madhësinë e tregut të Veriut të Kosovës, i cili është i lidhur territorialisht dhe ekonomikisht me Serbinë, si dhe nga fakti që Mitrovica e Veriut është qendra urbane e serbëve të Kosovës, e cila me sistemin e saj arsimor dhe të kujdesit shëndetësor tërheq gjithashtu shumë jorezidentë që kontribuojnë në ekonominë lokale.



Figurë: Shkalla e qarkullimit të bizneseve K-Serbe në vitin 2010 (Burimi: Riinvest)

## Konteksti i ndryshëm institucional për Kosovën Veriore dhe Graçanicën

Në një masë të caktuar, ekonomia e Veriut të Kosovës funksionon jashtë sistemit institucional të Kosovës, gjë e cila komplikon gjurmimin e treguesve ekonomikë në rajon. Prej 17 bizneseve nga katër komuna më veriore të intervistuar në këtë hulumtim, 8 prej tyre raportuan se janë të regjistruar në sistemin e Kosovës edhe në atë të Serbisë, 5 raportuan se janë regjistruar vetëm në sistemin e Kosovës dhe 4 raportuan se ose janë regjistruar vetëm në sistemin serb ose nuk janë regjistruar fare. Dy nga të anketuarit e intervistuar nga Graçanica deklaruan se ata janë regjistruar vetëm brenda sistemit të Kosovës.

<sup>46</sup> InTER, "Freakonomics of Northern Kosovo", 2018

<sup>47</sup> Kosovo Agency of Statistics

<sup>48</sup> Riinvest Institute, "Përmirësimi i Përfshirjes së Komunitetit Serb në Aktivitetet Ekonomike në Kosovë", 2012

Regjistrimi i dyfishtë ka qenë prej kohësh një realitet për bizneset në zonat me shumicë serbe në Veriun e Kosovës. Në anën tjetër, kjo praktikë është sjellë në minimum në zonat e jugut me shumicë serbe. Sipas shpjegimit të dhënë në tryezën e rrumbullakët, arsyeja kryesore për këtë ndryshim në mes të Graçanicës dhe Veriut të Kosovës qëndron në integrimin jo të plotë institucional të kësaj të fundit dhe lidhjen e saj territoriale me Serbinë, e cila u siguron atyre mundësinë që, ndryshe nga bizneset nga komunat e jugut, të importojnë mallrat nga Serbia përmes rrugëve alternative duke shmangur sistemin ligjor të Kosovës.

Siç shpjeguan pjesëmarrësit e tryezave të rrumbullakëta në Mitrovicën e Veriut, regjistrimi në sistemin e Serbisë thjeshton bashkëpunimin dhe shkëmbimin me kompanitë nga Serbia. Ky është një parakusht për nënshkrimin e marrëveshjeve të blerjes dhe furnizimit me institucionet serbe në Kosovë, të cilat janë një klient i rëndësishëm. Përveç kësaj, regjistrimi në sistemin e Serbisë u ofron bizneseve një mundësi për të shitur mallrat dhe shërbimet e tyre individëve të punësuar në sektorin publik serb përmes pagesave të ndryshme. Sipas hulumtimit të realizuar nga Riinvest në vitin 2015, shumica dërrmuese e shitjeve të bizneseve të regjistruara në veri të Kosovës, 90 përqind, janë shitje lokale, rreth 6 përqind janë shitur në pjesë të tjera të Kosovës, dhe më pak se 3 përqind e shitjeve janë bërë në Serbi. Burimi kryesor i të ardhurave vjen nga familjet serbo-kosovare me 62%, pasuar nga familjet shqiptare kosovare me 16%, bizneset e drejtuara nga serbët 8%, qeveria e Serbisë 7%, bizneset e drejtuara nga shqiptarët 3%, dhe 3% të tjera dhe qeveria e Kosovës 1%.<sup>49</sup>

Në anën tjetër, regjistrimi në sistemin e Kosovës është i nevojshëm për të bërë biznes me këdo tjetër në Kosovë. Por të bërit biznes në të dy sistemet paraqet një barrë për kompaninë pasi kërkon ruajtjen e dyfishtë të kontabilitetit, shlyerjen e detyrimeve të dyfishta administrative, etj.

Si trendi në Jug, kjo barrë e regjistrimit të dyfishtë shoqërohet gjithashtu nga përfitime në rënie

---

*"Unë rekomandoj bizneset mos të regjistrohen në sistemin e Serbisë. Varësisht nga muaji, sezona e dimrit apo e verës, kostot që kanë ata në sistemin serb janë rreth 9,000 - 9,500 dinarë për fitimin minimal. Në Kosovë, ata paguajnë 23 euro dhe 3% e fitimit gjatë tremujorit," tha një pjesëmarrës në tryezën e rrumbullakët nga sektori i OJQ-ve.*

---

edhe për biznesin në veri, paralajmëruan pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët. Siç shpjegoi njëri prej tyre, bizneset e drejtuara nga serbët e Kosovës të regjistruar në sistemin serb ishin në gjendje të eksportonin mallra në Serbi pa paguar detyrime. Sidoqoftë, që nga kohët e fundit, edhe bizneset me regjistrim serb por të vendosura në Kosovë janë gjithashtu nën detyrimin të paguajnë

---

*"Përderisa është e vështirë të depërtosh në tregun e gjerë të Kosovës, është shumë shtrenjtë të eksportosh mallin në tregun serb", tha prodhuesi serb i Kosovës nga Graçanica, i cili u përball me kosto të shumta dhe procedura të vështira administrative ndërsa përpiqej të eksportonte produktet e tij në Serbi.*

---

<sup>49</sup> [Riinvest Institute, "Potencialet Ekonomike në Veri të Kosovës", 2015](#)

detyrime dhe tarifa për eksportin e mallrave në Serbi. Pjesëmarrësi në tryezën e rrumbullakët gjithashtu dëshmoi se marrja e certifikatave të nevojshme për eksport në Serbi përbën një sfidë tjetër.

Dy pjesëmarrës në tryezë të rrumbullakët që kanë regjistrime të dyfishta ishin gjithashtu në gjendje të krahasonin efikasitetin e dy sistemeve. Të pyetur për të përcaktuar sasinë e kohës së nevojshme për të regjistruar një biznes në sistemin kosovar dhe serb, ata dëshmuuan se sistemi i Kosovës ishte shumë më i thjeshtë. Sipas përvojës së tyre, ndërsa në sistemin e Kosovës, nevojiten vetëm disa orë për të regjistruar një biznes; i njëjti proces zgjat për më shumë se një javë në sistemin serb. Ata gjithashtu theksuan se në sistemin e Kosovës, pasi të regjistrohet një firmë, mund të ndryshojë fushat e tyre kryesore të veprimtarisë lehtë, ose madje mund të jetë një biznes hibrid me zona pune që nuk janë të lidhura ngushtë, e kjo gjë do të kërkonte regjistrime të ndara në sistemin serb.

---

*"Këto dy sisteme që ende janë në konkurrencë dhe fakti që ne nuk e dimë se në cilën mënyrë do të zhvillohet kjo situatë, e që mbetet e pazgjidhur sepse të gjithë përpiqen t'i bëjnë gjërat të shkojnë sipas mënyrës së tyre. Kjo është përshtypja ime më e madhe, " - tha një pronar i një argjendarie në një tryezë diskutimi.*

---

Studime të tjera gjithashtu tregojnë ndryshimin në kontekstin institucional që operojnë bizneset e drejtuara nga serbët nga Veriu i Kosovës dhe komunat me shumicë serbe në jug. Sipas studimit të Riinvest nga viti 2012, 65% e ndërmarrjeve të Veriut të Kosovës ishin regjistruar vetëm në Regjistrin e Biznesit të Serbisë, 2% vetëm në Regjistrin e Biznesit të Kosovës dhe 32% në të dy sistemet. Në anën tjetër, rezultate të kundërta u morën në komunat me shumicë serbe në jug, ku 7.9% raportuan se ishin regjistruar në Regjistrin e Biznesit të Serbisë, 56% në Regjistrin e Biznesit të Kosovës, dhe 30% në të dy sistemet.

Po kështu, sipas InTER<sup>50</sup>, në vitin 2015, ishin 340 kompani që operojnë brenda sistemit serb. Ato ishin kryesisht mikro biznese dhe biznese vogla dhe vetëm një ishte ndërmarrje e madhe. I njëjti hulumtim zbuloi se pas zbatimit të Marrëveshjes së Brukselit, më shumë kompani nga Veriu i Kosovës u regjistruan në Regjistrin e Biznesit të Kosovës - nga 3180 kompani nga Veriu i Kosovës të regjistruara në sistemin e Kosovës nga viti 2000 deri në 2017, pothuajse gjysma ishin regjistruar pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Brukselit në vitin 2013.<sup>51</sup>

Gjegjësisht, zbatimi i Marrëveshjes së Brukselit dhe zbatimi i marrëveshjes IBM solli një realitet të ri në terren pasi u kërkoi bizneseve të ndryshojnë praktikën e tyre të veprimit, veçanërisht në lidhje me importin.

Për më tepër, edhe pse katër komuna më të veriut mbeten pjesërisht të integruara pasi integrimi ekonomik varet nga procesi i dialogut, dialogu gjithashtu solli stimulues për integrimin, siç është marrëveshja për mbledhjen e të ardhurave e nënshkruar në vitin 2013. Gjegjësisht, kjo

---

<sup>50</sup> InTER, "Freakonomics of Northern Kosovo", 2018

<sup>51</sup> Ibid

marrëveshje parashikonte që të gjitha të ardhurat e mbledhura në pikat e kalimit në Veri të Kosovës të transferohen në Fondin e Zhvillimit për Veriun. Fondi u krijua për zhvillimin socio-ekonomik të katër komunave më veriore. Deri në nëntor 2020, shuma totale prej 16.2 milion euro është mbledhur, nga të cilat 14.5 milion euro janë shpërndarë në katër komunat më veriore për projekte zhvillimore.<sup>52</sup>

Shumë agjenci dhe organizata ndërkombëtare të zhvillimit mbështetën zhvillimin e sektorit privat në Veri të Kosovës. Në mesin e tyre, më i rëndësishëm ishte roli i Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), si dhe disa ambasada të vendeve perëndimore (kryesisht Britania e Madhe, Norvegjia dhe Finlanda). Mbështetja për ndërmarrjet më së shpeshti është siguruar përmes granteve financiare dhe jo-financiare, dhe në një masë më të vogël, mbështetja sigurohet përmes trajnimeve për zhvillimin e biznesit. Vetëm përmes dy skemave të granteve për Veriun e Kosovës të shpallura nga BE, midis 2013 dhe 2016, ishin ndarë 2 milion euro për zhvillimin e sektorit privat dhe rreth 2.8 milion euro për zhvillimin e bujqësisë<sup>53</sup>. Skemat e dhëna të granteve shërbyen gjithashtu si një nxitje për bizneset e Veriut të Kosovës për t'u regjistruar në Regjistrin e Bizneseve të Kosovës.

Më shumë informacione mbi kontekstet e ndryshme për bashkëpunim ndëretnik në mes të Veriut të Kosovës dhe Graçanicës do të shtjellohen në kapitullin, i cili analizon statusin aktual dhe pengesat në bashkëpunim.

## Klima sfiduese e investimeve

Sipas intervistave të zhvilluara me bizneset e drejtuara nga serbët, theksohet se pavarësisht se kanë potenciale zhvillimi në vendndodhjen gjeografike, zhvillimin e turizmit, bujqësinë dhe pylltarinë, klima e investimeve mbetet e pakënaqshme në Kosovën e Veriut dhe Graçanicë.

Bizneset e pazhvilluara dhe mungesa e investimeve ndikojnë në konkurrencën e këtyre ndërmarrjeve dhe pozicionimin e tyre në tregun e gjerë të Kosovës. Përveç faktit që varësia ekonomike nga sektori publik bën që komuniteti të mos ketë motivim për tu angazhuar dhe për të filluar një biznes, arsyt kryesore për sektorin privat të pazhvilluar në zonat e populluara serbe janë shkaktuar nga paqëndrueshmëria politike, marrëdhëniet e dobëta ndëretnike dhe mosbesimi ndaj sistemit institucional.

Marrëdhëniet e pazgjdhura politike në mes të Serbisë dhe Kosovës sjellin pasiguri për investitorët e sektorit privat në zonat me shumicë serbe të Kosovës. Shumica e kompanive të intervistuar nga Veriu i Kosovës deklaruan se situata e paparashikueshme politike dhe në veçanti njoftimet për korrigjimin e kufijve i pengojnë ata të bëjnë plane biznesi afatgjata.

Kompanitë e drejtuara nga serbët janë unanime dhe deklaruan se paqëndrueshmëria politike në Kosovë ndikon në dëshirën e tyre për të investuar më tej dhe për të zhvilluar biznesin e tyre. Një

<sup>52</sup> <http://crnobelisvet.com/o-fondu-za-razvoj-severa-kosova/>

<sup>53</sup> Ibid

sipërmarrës serb deklaroi se ai do të dëshironte që situata politike të stabilizohej në mënyrë që ai të zhvillonte një plan biznesi, të merrte një kredi, të investonte në modernizim.

---

*"Sinqerisht, unë supozoj se partnerët e tjerë ndërmarrës kanë të njëjtin problem sepse askush nuk dëshiron të investojë para të mëdha në diçka të paparashikueshme në një të ardhme të afërt, për të mos përmendur një të ardhme të largët. Nuk mund të flasim për plane afatshkurtra, e lëre më për plane afatgjata", tha një ndërmarrës nga Leposaviqi në intervistë.*

---

Përgjigja më e zakonshme në lidhje me këtë çështje në mesin e bizneseve të intervistuar është se duhet të arrihet një zgjidhje e përhershme për marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke refuzuar megjithatë të specifikojnë se çfarë saktësisht duhet të jetë ajo zgjidhje - arritja e një zgjidhjeje të pranueshme nga të dy vendet, duke zvogëluar tensionet ndëretnike dhe urrejtjen, ishin disa nga sugjerimet e paqarta.

Për më tepër, sundimi i ligjit dhe niveli i besimit ndaj sistemit institucional janë parakushte thelbësore për investime ekonomike. Besimi ndaj sistemit gjyqësor të Kosovës mbetet i ulët<sup>54</sup>, dhe sistemi institucional i Kosovës nuk po dërgon mesazhe mjaftueshëm pozitive në lidhje me mbrojtjen institucionale.

Për shembull, ish-Agjencia Kosovare e Pronave, e cila tani është riemëruar në Agjenci për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, AKKVP, kishte regjistruar 42,749 prona të sekuestruara në Kosovë. Sipas Arian Krasniqit, zëdhënës i AKKVP, 96.84 përqind ose 41,399 e pronave të uzurpuara u përkisnin serbëve.<sup>55</sup>

---

<sup>54</sup> Sipas sondazhit të ADRC të realizuar në katër komunat më veriore në vitin 2019, vetëm 9% e të anketuarve serb kanë besim në systemin gjyqësor të Kosovës pas integritit të gjyqësorit në rajonin e Mitrovicës.

Referenca: [Qendra për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve, "Drejtësia në Rajonin e Mitrovicës: Hulumtim i Perceptimit Publik" 2020](#)

<sup>55</sup> <https://balkaninsight.com/2018/05/29/stolen-homes-kosovo-struggles-with-wartime-property-seizures-05-22-2018/>

## Seksioni 2.

---

### Gjendja aktuale e bashkëpunimit ndëretnik dhe pengesat kryesore

Ndërlidhja e kufizuar ekonomike në mes të bizneseve të drejtuara nga serbët dhe shqiptarët kushtëzohet nga probleme në shume fusha: sociale, ekonomike dhe politike.

Ndryshe nga bashkëpunimi ekonomik në mes të Kosovës dhe Serbisë, ku mund të matet shkalla e bashkëpunimit, niveli i bashkëpunimit ekonomik midis bizneseve të drejtuara nga serbët dhe bizneseve të drejtuara nga shqiptarët brenda Kosovës është vështirë të përcaktohet pasi nuk ka të dhëna dhe statistika për bashkëpunimin e biznesit në nivel ndër-komunal.

Sidoqoftë, niveli i bashkëpunimit mund të supozohet bazuar në disa nga hulumtimet në dispozicion. Gjegjësisht, sipas studimit të NGO Aktiv nga viti 2013<sup>56</sup>, nga 331 kompani të anketuara nga Veriu i Kosovës, vetëm 18% e tyre ishin ekonomikisht aktive në zonat me shumicë shqiptare. Në anën tjetër, studimi i Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara nga viti 2016, brenda të cilit ata intervistuan 800 NVM dhe fermerë, tregon se ndërveprimi ekonomik midis komunave me shumicë shqiptare dhe atyre me shumicë serbe të rajonit të Mitrovicës është shumë i vogël. Më pak se 10% e NVM-ve dhe fermerëve nga të dy palët pretenduan të bënin biznes me nën-rajonin tjetër shpesh ose shumë shpesh. Gjashtëdhjetë e katër përqind e NVM-ve në zonat me shumicë shqiptare deklaruan se ata kurrë nuk bëjnë biznes me kompani të drejtuara nga serbët nga rajoni i Mitrovicës krahasuar me 37% të NVM-ve në zonat me shumicë serbe të cilët deklaruan të njëjtën gjë kur u pyetën për bashkëpunimin me bizneset e drejtuara nga shqiptarët nga rajoni. E njëjta gjë është rasti për fermerët në të dy nën-rajonet.<sup>57</sup>

Për më tepër, sipas të gjeturave të këtij hulumtimi, nga 14 biznese të intervistuar të drejtuara nga shqiptarët, 7 prej tyre deklaruan se bashkëpunojnë me bizneset e drejtuara nga serbët. Nga ana tjetër, nga 17 biznese të intervistuar nga serbët nga katër komuna më veriore, 14 prej tyre raportuan se kanë bashkëpunuar me biznese të drejtuara nga shqiptarët dhe 16 prej tyre shprehën interes për krijimin dhe rritjen e bashkëpunimit.

Sipas intervistave të zhvilluara, ka tregues që dëshmon se bashkëpunimi ndëretnik po rritet.

---

*"Tensionet politike ndonjëherë ndikojnë në treg, por bashkëpunimi me bizneset serbe po rritet. Ne nuk mund të themi se është i shkëlqyeshëm, por është i mirë. Është një proces", tha një pronar i një kompanie ndërtimi të drejtuar nga shqiptarët nga Mitrovica e Jugut.*

---

<sup>56</sup>NGO Aktiv, "Një Hetim mbi Situatën Ekonomike të Biznesit në Veriun e Kosovës", 2013

<sup>57</sup>UNDP, "Rajoni i Mitrovicës Vlerësimi Bazë", 2016

Shumica e të anketuarve serbë të cilët bashkëpunojnë me kompani nga komunitetet e tjera deklarojnë se përqindjet e këtij bashkëpunimi janë nën 35%, ndërsa në disa raste (3)<sup>58</sup> ekziston një shkallë jashtëzakonisht e lartë e bashkëpunimit me këto kompani pasi që ata deklaruan se nga të gjitha shkëmbimi ekonomik, nga 80 në 90% po zhvillohet me bizneset e drejtuara nga shqiptarët. Është e rëndësishme të ceket se 2 nga 3 kompani të intervistuar të cilat drejtohen nga serbët që kanë një shkallë të lartë bashkëpunimi janë nga Graçanica. Kjo përsëri tregon kontekstin e ndryshëm në krahasim me bizneset serbe nga komunat më veriore.

---

*"Kompanitë serbe në Graçanicë hasin probleme me importin e mallrave serbe dhe pagesën e detyrimeve doganore. Nëse kufiri do të ishte i hapur, unë mendoj se si për mua do të ishte më fitimprurëse për ata të importonin gjithçka nga Serbia."*

---

Pjesëmarrësit e tryezës së rrumbullakët nuk u befasuan kur mësuuan se një nga rezultatet e hulumtimit dëshmoi se në mes të korpusit të bizneseve të drejtuara nga serbët, më shumë biznese nga Graçanica, sesa ato nga Veriu i Kosovës ishin të angazhuar në bashkëpunim me bizneset e drejtuara nga shqiptarët. Ata u pajtuan që arsyeja kryesore për këtë ishte vendndodhja gjeografike - më larg nga kufiri me Serbinë dhe më afër qendrave urbane me shumicë shqiptare.

Për të mbështetur pretendimin, pronari i një shitoreje me produkte druri deklaroi se ai kohët e fundit kërkoi për një lloj të veçantë të drurit për dysheme që kushtonte 18 euro për metër katror në Babimoc, krahasuar me 13 euro në Novi Pazar.

Bashkëbiseduesit tjerë theksuan se bizneset në zonën e Graçanicës kanë vendosur lidhje biznesi me shumicën e popullsisë për shumë më gjatë sesa komuniteti i Kosovës së Veriut, i cili ishte i ndarë plotësisht nga pjesa tjetër e Kosovës deri në 2013.

Një përfaqësues i një OJQ-je shqiptare nga Mitrovica e Jugut gjithashtu nënvizoi rëndësinë e presionit politik para vitit 2013 në Veri të Kosovës për të mos bashkëpunuar me shqiptarët.

---

*"Bizneset serbe nga Veriu e kanë pasur më të vështirë të bashkëpunojnë me bizneset nga Jugu pasi që kanë qentë frikësuar nga qeveria serbe për të mos bashkëpunuar. Në vitin 2008, kur ishte periudha më e vështirë për të bërë biznes, në Veri kishte pamfleta drejtuar serbëve me mesazhin që nëse bashkëpunojnë me organizata ose biznese shqiptare, ata do të etiketohen si tradhëtarë," tha ky bashkëbisedues duke theksuar se fondet ndërkombëtare kanë ndikuar shumë për ta lehtësuar këtë gjendje.*

---

Lloji dhe madhësia e biznesit është një nga faktorët që kontribuojnë në gatishmërinë për bashkëpunim në mes të bizneseve të drejtuara nga serbët dhe atyre të drejtuar nga shqiptarët, thonë pjesëmarrësit e tryezës së rrumbullakët. Për shembull, bizneset tregtare dhe prodhuese

---

<sup>58</sup> Dy kompani nga Graçanica dhe një kompani nga Zubin Potok



serbe janë më të hapura për krijimin e bashkëpunimit me zinxhirët më të mëdhenj të shitjes me pakicë në zonat me shumicë shqiptare sepse ata mund të hyjnë në një treg që është më i madh se ai i Veriut të Kosovës dhe të gjitha zonat me shumicë serbe së bashku, tha një pjesëmarrës nga një OJQ serbe në Mitrovicën e Veriut në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga ADRC.

---

*"Ata (prodhuesit serb nga Veriu i Kosovës) janë të vetëdijshëm se sa e vështirë është të vendosen mallrat në tregun e Serbisë, i cili është shumë i madh. E gjitha vjen për faktin se bizneset serbe nga Veriu kanë produkte që mund t'i vendosin në tregun e Kosovës sepse nuk ka produkte të tilla në atë treg. Në anën tjetër, ka pak kuptim për ata të përpiqen të eksportojnë ato produkte përsëri në Serbi pasi ato ka të ngjarë të jenë importuar tashmë nga Serbia si produkte gjysëm të gatshme dhe janë gjerësisht të disponueshme në tregun serb. Ata nuk mund të bëjnë fitim në këtë mënyrë".*

---

Interesi për bashkëpunim është gjithashtu i lartë me bizneset e intervistuar të drejtuara nga shqiptarët. Sidoqoftë, kompanitë më të mëdha nuk janë në atë masë të interesuara të përfshijnë biznese të drejtuara nga Serbia në zinxhirin e tyre të furnizimit, jo domosdoshmërisht për shkak të përkatësisë së tyre etnike, por më tepër sepse këto biznese janë të vogla dhe nuk mund të angazhohen për një furnizim të qëndrueshëm.

---

*"Kompanitë e mëdha thjesht nuk janë të interesuara të bashkëpunojnë me kompani të vogla, qofshin ato kompani të drejtuara nga një shqiptar apo një serb. Ekziston mosbesimi ndaj kompanive të vogla që ato nuk mund të angazhohen për një furnizim të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm të një malli të caktuar për kompanitë e mëdha të përqëndruara në prodhim ose tregti. Kompanitë e mëdha më shumë preferojnë të zgjedhin furnizues të mëdhenj dhe të qëndrueshëm.", shpjegoi një biznesmen shqiptar nga Prishtina.*

---

Një faktor tjetër që rezultoi në interesin dukshëm më të vogël të bizneseve të drejtuara nga shqiptarët për të bashkëpunuar me bizneset e drejtuara nga serbët ka të ngjarë të qëndrojë në faktin se bizneset e drejtuara nga serbët në Veri të Kosovës operojnë kryesisht jashtë kornizës ligjore, që do të thotë se mallrat që ata ofrojnë importohen shpesh në mënyrë të paligjshme ose sepse hezitojnë të lëshojnë gjithmonë fatura fiskale të cilat e bëjnë të pamundur krijimin e bashkëpunimit plotësisht ligjor me bizneset e drejtuara nga serbët në veri të Kosovës, thotë një sipërmarrës nga Mitrovica e Veriut.

Për një bashkëbisedues nga Mitrovica e Jugut, kjo çështje shihet si një nxitje e mundshme shtesë për bashkëpunimin e bizneseve serbe që veprojnë legalisht me bizneset e drejtuara nga shqiptarët.

---

*" Përveç tregut më të madh dhe më të lirë, bizneset serbe janë më të interesuara për të marrë mallra në pjesën jugore sepse atyre u duhet të marrin fatura. Bizneset në pjesën e Jugut zakonisht veprojnë në mënyrë ligjore dhe nuk marrin mallra të kontrabanduar për shkak të inspektimit," - tha ky biznesmen shqiptar.*

---

Përveç çështjeve ligjore me mallrat serbe, edhe shqiptarët mund të përballen me vështirësi në vendosjen e produkteve të tyre në mikro-tregun në Veri të Kosovës, thanë të anketuarit. Një pikë e bërë nga një pronar i një dyqani bizhuterish, i cili u përpoq të shpjegonte fakti se bizneset e drejtuara nga shqiptarët treguan ngurrim disi më të lartë për bashkëpunim, siç tha ai, në lidhje me cilësinë e produkteve. Ai pretendon se produktet nga Serbia që janë të pranishme në tregun e Veriut të Kosovës janë më cilësore ose, të paktën, më të besuar nga qytetarët, disa produkte nga tregu i gjerë i Kosovës nuk do të ishin konkurrese nëse do të ofroheshin në Veriun e Kosovës.

Megjithatë, pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët të dytë u pajtuan pjesërisht, duke pretenduar se disa produkte, si ëmbëlsirat, nuk do të ishin konkurrese. Llojet e tjera të produkteve, si produktet e pastrimit, tashmë janë gjerësisht të pranishme dhe përdoren nga

---

*" Veriu i Kosovës është mësuar me një lloj tjetër të produkteve. Duke folur realisht, këto produkte janë me cilësi më të mirë. Babai im ka një dyqan dhe unë e di se çfarë lloj produktesh ofrojnë shqiptarët; fëmijët e mi nuk do të hanë ato produkte. Këto janë ëmbëlsira nga Turqia të paketuara bukur, por pa shije. Cilësia është në një nivel më të ulët se Pionir, Stark... Ne jemi zgjedhës..., " - tha një prodhues bujqësor nga Zubin Potok.*

---

konsumatorët në zonat me shumicë serbe.

Kjo situatë ishte pasqyruar në Graçanicë deri vonë, deklaroi një i intervistuar nga ky qytet. Kjo ndryshoi pas vendosjes së tarifës 100% ku konsumatorët u detyruan të blinin produkte që nuk ishin nga Serbia.

---

*"Për dallim nga Veriu i Kosovës, tarifa 100% eliminoi mundësinë e blerjes së produkteve serbe në Graçanicë. Megjithëse shprehitë tona të konsumit më parë ishin të orientuara drejtë produkteve serbe, pasi u ndërpreen këto produkte, ne kuptuam se ka shumë produkte të Kosovës me cilësi të mirë", tha një sipërmarrës nga Graçanica, duke dëshmuar edhe një dallim tjetër në kontekstin e zonave me shumicë serbe në rajonin e Mitrovicës dhe Graçanicës, gjë e cila ishte diskutuar gjatë në kapitullin e mëparshëm.*

---

Se tregu i Kosovës lufton me një larmi ofertash në treg është gjithashtu përshtypja e pronarit të dyqanit të argjendarisë i cili veçanërisht nënvizoi çështjet e tregut të ilaçeve. Brezat e vjetër të shqiptarëve janë klientë të shpeshtë të barnatoreve në zonat me shumicë serbe pasi ato ofrojnë ilaçe që janë ose më të lira ose nuk janë të disponueshme në zonat me shumicë shqiptare.

Prodhuesit vendorë në veri përballen me një pengesë tjetër, produktet e tyre nuk janë aq konkurrese sa mallrat nga Serbia ose tregu i gjerë i Kosovës. Kjo është posaçërisht e vërtetë për produktet bujqësore, deklaroi një nga prodhuesit që ankohej se taksa e importit për produkte të tilla në Kosovë është vetëm 3%. Në të njëjtën kohë, standardet për cilësinë janë të ulëta, duke e bërë të vështirë për prodhuesit vendorë të gjejnë vendin e tyre në treg.

---

*"Kur bëhet fjalë për produktet bujqësore, ato hyjnë në treg nga të gjitha anët. Të gjithë kërkojnë të gjejnë mallra me çmimin më të ulët të mundshëm, dhe cilësia është krejtësisht e parëndësishme. Njerëzit hanë dhe pinë prodhime bujqësore të cilësisë më të ulët. Dhe pozicioni ynë gjeografik është i keq për bujqësinë. Çdo gjë piqet më vonë kur krahasohet me rajonin," - tha një prodhues nga Zveçani.*

---

Përrjashtime të rralla janë prodhuesit që arritën të marrin fonde të konsiderueshme të BE-së dhe tani eksportojnë në Francë dhe Gjermani, si Familja Bujqësore nga Zubin Potok dhe prodhuesi i vajit eterik nga Leposaviq.

Në fund, shpërndarja poashtu nuk është një opsion fitimprurës për bizneset e vendosura në Veriun e Kosovës. Siç theksoi një nga pjesëmarrësit, ato biznese në Kosovë që duan të tregtojnë me Serbinë mund ta bëjnë atë drejtëpërdrejtë, pa përdorur kontakte në Veriun e Kosovës si ndërmjetësues.

Pavarësisht pengesave të përmendura, disa nga bizneset e intervistuar nga rajoni i Mitrovicës, nga të dy komunitetet serbe dhe shqiptare, deklaruan se bashkëpunimi ndikoi pozitivisht në përceptimin e tyre personal ndaj komunitetit tjetër.

Pjesëmarrësit në një tryezë të rrumbullakët deklaruan se vetëm fitimi është interesi i bizneseve më të mëdha siç janë zinxhirët me pakicë, ndërsa bizneset e tjera më të vogla pashmangshmërisht përjetojnë efekte të tjera pozitive të bashkëpunimit, që nuk lidhen vetëm me rritjen e fitimit.

---

*"Kjo është në përpjesëtim të kundërt me madhësinë e biznesit. Unë mendoj se bizneset e mëdha e bazojnë marrëdhënien e tyre në interes, por ato që janë të vogla, në emër të të cilave pronari flet dhe shpesh investojnë gjithçka që kanë ... që flet për nivelin e besimit që të dy palët investojnë në biznes. Ky besim mund të çojë në miqësi, sigurisht para se të ndodhë e njëjta gjë midis dy supermarketeve dhe menaxhimit të tyre, "tha një përfaqësues i OJQ-ve nga Mitrovica e Veriut.*

---

Kjo u konfirmua nga një bashkëbisedues shqiptar i cili menaxhon një biznes dhe jeton në Mahallën e Boshnjakëve, një lagje multietnike në Mitrovicën e Veriut, i cili deklaroi se pas luftës, lagjja e tij ishte si një qytet fantazmë. Sidoqoftë, me kalimin e viteve, tensionet u qetësuan dhe bizneset e para u hapën në këtë zonë. Bizneset konstante dhe ato në rritje bashkëpunuan kryesisht në tregtinë e mallrave me pjesën tjetër të pjesës veriore, duke çuar në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike në këtë pjesë të qytetit. Sot, Mahalla e Boshnjakëve është një nga lagjet më të ngarkuara në Mitrovicën e Veriut.

Një punëtor bujqësor në diskutimin e një tryeze tjetër të rrumbullakët ishte përfshirë me organizimin e prezantimeve të prodhuesve serbë në panairë në zonat urbane me shumicë shqiptare. Ai dëshmoi për përvoja shumë pozitive nga ngjarje të tilla duke deklaruar se ai vetë dhe prodhuesit e tjerë kishin mundësinë të mësonin shumë rreth paketimit dhe vendosjes së projekteve.

Përfaqësuesi i OJQ-së realizoi një program të ngjashëm. Ata po lidhnin prodhuesit serbë të produkteve shtëpiake dhe restorantet dhe pronarët e tjerë të bizneseve të mikpritjes nga zonat me shumicë shqiptare. Fatkeqësisht, pavarësisht nga interesi i madh fillestar, për shkak të pandemisë Covid-19, prezantimet u realizuan në mënyrë virtuale në vend se të bëhen fizikisht, dhe blerësit nuk patën mundësinë për të provuar produktet dhe kështu ishin më pak të gatshëm të fillojnë bashkëpunimin në fund.

Shkëmbimi i shërbimeve është gjithashtu fusha ku ndërpritet bashkëpunimi. Sipas të intervistuarve, lloji më i dukshëm i shërbimeve që bizneset e drejtuara nga serbët dhe individët i marrin nga homologët shqiptarë ka të bëjë me zgjidhjen e detyrimeve dhe problemeve të tyre para institucioneve të Kosovës, të tilla si punësimi i një avokati ose punësimi i një kompanie të kontabilitetit ose auditimit. Gjegjësisht, fakti që Veriu i Kosovës ka funksionuar plotësisht jashtë sistemit institucional të Kosovës çoi në një situatë në të cilën individëve dhe komunitetit të biznesit në Veri të Kosovës u mungon njohuria për funksionimin e sistemit institucional.

---

*"Unë e di sigurt që një furrë e madhe nga Veriu punësoi një kompani të mbajtjes së librave nga Mitrovica e Jugut. Kompanitë e kontabilitetit dhe administrimit financiar nga zonat me shumicë shqiptare janë më me përvojë sepse ata e kuptojnë më mirë sistemin, procedurat dhe detyrimet ndaj Administratës Tatimore dhe inspektimeve", - shpjegon njëri sipërmarrës nga Zubin Potok.*

---

Pengesa gjuhësore dhe zbatimi i dobët i Ligjit për përdorimin e gjuhëve gjithashtu kontribuojnë në vendimin e tyre për të punësuar një ofrues të shërbimeve shqiptare. Ata preferojnë më tepër të zgjedhin një avokat shqiptar pasi besojnë se ai / ajo e kupton më mirë sistemin, e din gjuhën dhe si rezultat, rastet e tyre do të kishin trajtim më të mirë para institucioneve nëse kanë avokatë shqiptarë që t'i përfaqësojnë ata.<sup>59</sup>

Për më tepër, një sipërmarrës shqiptar theksoi se shkëmbimi i shërbimeve është gjithashtu shumë i pranishëm në sektorin e ndërtimitarisë:

---

*"Kompanitë tona të ndërtimit (të drejtuara nga shqiptarët) janë më të zhvilluara se ato në Veriun e Kosovës. Ne kemi fuqi punëtore më me përvojë dhe makineri më të mira, dhe për këtë arsye çmimet tona janë shumë konkurruese. Bashkëpunimi po shkon shumë mirë, dhe ne jemi shumë të kënaqur".*

---

Në anën tjetër, pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët theksuan se shërbimet mjekësore të specializuara nga praktikantët private në Veri të Kosovës përdoren gjerësisht edhe nga konsumatorët shqiptarë.

Është e rëndësishme të theksohet se marrëdhëniet e dobëta ndëretnike po ndikojnë në shkëmbimin e shërbimeve në nivelin individual. Sipas elaborimeve nga pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët, megjithëse është përmirësuar që nga viti 2013, ky shkëmbim mbetet i ulët.

---

*"Shumë pak shqiptarë do të shkonin në Mitrovicën e Veriut për një kafe ose për të prerë flokët ose në një klub lojrash; e njëjta gjë qëndron për serbët që vijnë në Jug. Kjo mbetet e kufizuar kryesisht për ata njerëz që janë të lëvizshëm në anën tjetër të qytetit sepse punët e tyre janë të vendosura atje," - tha një pjesëmarrës shqiptar në një tryezë të rrumbullakët.*

---

Në fund, është e rëndësishme të theksohet se Covid-19 pati ndikim të madh negativ në ekonominë e Kosovës në përgjithësi, bashkëpunimi ndëretnik nuk ishte përjashtim. Fondi Monetar Ndërkombëtar vlerëson se BPV-ja e Kosovës është kontraktuar me 7.5% në vitin 2020 për shkak të

---

<sup>59</sup> [Qendra për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve, "Drejtësia në rajonin e Mitrovicës: Hulumtim i Perceptimit Publik" 2020](#)

Covid-19. Izolimi dhe ora policore ulën edhe më shumë lëvizshmërinë dhe aktivitetin e përgjithshëm ekonomik.

Ndërmarrësit shqiptarë dhe serbë elaboruan efektet negative ekonomike në bizneset e tyre si dhe në bashkëpunimin ndëretnik.

---

*" Qarkullimi im u ul për 50%, dhe unë u detyrova të pushojë nga puna tre punonjës. Natyrisht, aktiviteti i ulur ekonomik ndikoi në nivelin tonë të bashkëpunimit ekonomik në përgjithësi, e lëre më në bashkëpunimin në shkallë të vogël që kemi pasur me bizneset serbe ", theksoi sipërmarrësi shqiptar.*

---

Në anën tjetër, sipërmarrësi serb theksoi një përvojë të ngjashme:

---

*"Biznesi im operonte në sektorin e arsimit. Një muaj pas izolimit, më duhej ta mbyllja biznesin dhe të pushoja dymbëdhjetë punonjës. Fillova të punoj për zgjerimin e këtij biznesi në Prishtinë me partnerin tim shqiptar, por ne duhej ta ndalonim atë projekt përkohësisht."*

---

Një shembull shtesë i çuditshëm se si dezinformimi lidhur me COVID-19 ndikoi në biznesin e tij u përcoll nga një fermer i cili u intervistua për këtë hulumtim:

---

*"Në qershorin e kaluar, ne prodhuam 10 tonë lakër dhe kemi arritur të shesim pesë tonë para se babai im të kontrakttojë virusin. Pesë tonët e lakrës së mbetur shkuan dëm sepse bashkësia lokale dhe shitësit e tregut kishin frikë ta blinin atë nga ne, nga frika se mos infektoheshin përmes lakrës që prodhuam".*

---

## Si ndikojnë në bashkëpunim gjuha, përceptimi i sigurisë dhe politika

### Hendeku gjuhësor në rritje

Sipas hulumtimit, një nga pengesat më të mëdha për bashkëpunim më të lartë është pengesa gjuhësore. Ndarjet që mbizotëruan pas konfliktit, së bashku me faktin se mësimi i gjuhës në shkollat shqipe dhe serbe u ndërpre 30 vjet më parë, ka çuar në pikën ku shumica e serbëve dhe shqiptarëve nuk flasin gjuhën e njëri-tjetrit, duke krijuar kështu një pengesë gjuhësore. Sipas një studimi tjetër të realizuar nga Qendra për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve e në Mitrovicën Veriore dhe Jugore në vitin 2018<sup>60</sup>, nga 1.000 qytetarë të pyetur, vetëm 13.9% flisnin gjuhën e

---

<sup>60</sup> [Qendra për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve, "A mund të kuptojmë njëri-tjetrin", 2019](#)

njëri-tjetrit. Përveç kësaj, 60% e të anketuarve deklaruan se nuk ndihen të sigurt të flasin gjuhën e tyre në zonat ku komuniteti i tyre është pakicë. Kjo korrespondon me shumicën e përgjigjeve të marra përmes këtij studimi pasi shumica e bizneseve të intervistuar raportuan se mungesa e njohurive gjuhësore është problemi kryesor që pengon bashkëpunimin, pasuar nga situata politike/tensionet dhe mungesa e lëvizshmërisë e cila gjithashtu i pengon ata të hulumtojnë mundësitë e mundshme të biznesit.

---

*"Personalisht, problemi më i madh për mua është mos njohja e gjuhës dhe sigurisht që do të bashkëpunoja më shumë nëse do të dija gjuhën. Kur shkoj në Jug ose kur shqiptarët vijnë tek unë, unë mbështetem në anglisht, por nëse ai ose ajo nuk flet anglisht, atëherë unë jam në telashe," - tha në intervistë një prej të anketuarve serbë.*

---

E njëjta gjë u identifikua si problem nga akterët tjerë joqeveritarë të cilët kanë bërë përpjekje për ta lehtësuar këtë gjë. Në intervistën tonë me Odën Ekonomike të Kosovës, ata deklaruan se ishin angazhuar në promovimin e iniciativave që ofrojnë shërbime dhe mjete në lidhje me mësimin e gjuhës. IOM ka krijuar fjalorin dixhital, i cili është fjalori i parë në internet shqip-serbisht-shqip me 20,000 fjalë i realizuar përmes mbështetjes së UNMIK-ut.

Një zgjidhje më e qëndrueshme për problemin do të ishte vendosja e të dy gjuhëve zyrtare (shqip dhe serbisht) në kurrikulën e shkollave shqipe dhe serbe. Sidoqoftë, kjo mbetet një çështje e ndjeshme dhe emocionale për komunitetet pasi mësimi i gjuhës së "palës tjetër" në një farë mase perceptohet si një akt nënshtrimi. Sipas hulumtimit të realizuar në Veri dhe Jug të Mitrovicës, 65% e të anketuarve shqiptarë dhe serbë janë kundër vendosjes së gjuhës së komunitetit tjetër në shkolla.<sup>61</sup>

## Përceptimi i sigurisë ndikon në lëvizje

Marrëdhëniet e dobëta ndëretnike dhe pengesa gjuhësore gjithashtu ndikojnë në përceptimin e sigurisë për shumë shqiptarë dhe serbë të cilët nuk ndihen komod të lëvizin lirshëm në zonat ku komuniteti i tyre nuk është shumicë.<sup>62</sup>

Pengesa në krijimin e bashkëpunimit ka më shumë nuanca pasi ka zona me shumicë serbe që perceptohen si të sigurta nga shqiptarët (Graçanica) dhe ato që perceptohen si më pak të sigurta (katër komuna më veriore). E njëjta gjë qëndron për komunitetin serb; Prishtina perceptohet më e sigurt se Mitrovica e Jugut, Vushtrri dhe Skenderaj.

---

*"Marrëdhëniet ndëretnike janë shumë më të relaksuara kur kaloni Vushtrrinë dhe arrini në Prishtinë," - tha një sipërmarrës nga Leposaviq gjithashtu duke shtuar se situata u përmirësua shumë me kalimin e viteve.*

---

<sup>61</sup> Qendra për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve, "A mund të kuptojmë njëri-tjetrin", 2019

<sup>62</sup> Ibid

Përceptimi i sigurisë ndikon gjithashtu në bizneset e drejtuar nga shqiptarët dhe individët për të lëvizur lirshëm në Veriun e Kosovës. Si rrjedhojë, kjo zvogëlon lëvizshmërinë e tyre në rajon dhe shanset për të eksploruar mundësitë e biznesit.

Pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët nuk ishin të befasuar me këtë gjetje dhe shpjeguan këtë dallim në përceptimin e sigurisë në mes të rajonit të Mitrovicës dhe Prishtinës dhe Graçanicës si rezultat i konfliktit 1998-1999, i cili ishte më intensiv në rajonin e Mitrovicës sesa në Prishtinë, si dhe për shkak të pasojave të tensioneve politike me dekada të gjata të cilat kryesisht kishin epiqendrën në komunat më veriore. Ata e përshkruan Kosovën e Veriut si zona ku takohen dy nacionalizmet.

